



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0717

Paneli Shqyrtues, duke vendosur në përbërje nga Kimete Gashi Kryetare, Batisha Ibrahim Anëtare dhe Vedat Poterqoi Anëtar në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) lidhur me ankesën e OE “Roza Koman”i B.I., ushtruar kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Participim me projektet e DEMOSI-it-Pjesa e dyte Aktiviteti 2 LOT 1-Vazhdimi i ndërtimit të trotuarit dhe ndriçimi nga fshati Vitomirice deri te fshati Novoselle (Rruga R106) LOT 2- Ndërtimi i trotuarit pranë stacionit të autobusëve LOT 3-Ndertimi i trotuarit dhe ndriçimi publik ne lagjen Asllan Qeshmë rregullimi i hapësirës publike ne Qendrën Zejtare dhe te Ura e Gurit LOT 4- Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimi publik ne fshatrat Loxhe (Rr.Deme Isufi) dhe ne rrugën Hida Halimi ne lagjen Dardania” me numër të prokurimit 635-24-4438-5-1-1, iniciuar nga “KOMUNA E PEJES” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), më 17/10/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet pajtimi i palëve**, për ankesën e OE “Roza Koman”i B.I. me nr. 2024/0717, e datës 05/08/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Participim me projektet e DEMOSI-it-Pjesa e dyte Aktiviteti 2 LOT 1-Vazhdimi i ndërtimit të trotuarit dhe ndriçimi nga fshati Vitomirice deri te fshati Novoselle (Rruga R106) LOT 2- Ndërtimi i trotuarit pranë stacionit të autobusëve LOT 3-Ndertimi i trotuarit dhe ndriçimi publik ne lagjen Asllan Qeshmë rregullimi i hapësirës publike ne Qendrën Zejtare dhe te Ura e Gurit LOT 4- Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimi publik ne fshatrat Loxhe (Rr.Deme Isufi) dhe ne rrugën Hida Halimi ne lagjen Dardania”, me numër të prokurimit 635-24-4438-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PEJES” .

2. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Me 07.05.2024, “KOMUNA E PEJES” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për Kontratë (NJK) dhe dosjen e tenderit (DT), për aktivitetin e prokurimit “Participim me projektet e DEMOSI-it-Pjesa e dyte Aktiviteti 2 LOT 1-Vazhdimi i ndërtimit të trotuarit dhe ndriçimi nga fshati Vitomirice deri te fshati Novoselle (Rruga R106) LOT 2- Ndërtimi i trotuarit pranë stacionit të autobusëve LOT 3-Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimi publik ne lagjen Asllan Qeshmë rregullimi i hapësirës publike ne Qendrën Zejtare dhe te Ura e Gurit LOT 4- Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimi publik ne fshatrat Loxhe (Rr.Deme Isufi) dhe ne rrugën Hida Halimi ne lagjen Dardania” evidentuar me numër të prokurimit 635-24-4438-5-1-1.

Me 23.07.2024 OE “Roza Koman”i B.I. nga cilësia e tij/sajë si palë e pakënaqur me vendimin e cituar ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar me Vendimin e AK të datës 25.07.2024. Kurse, me 05.08.2024 OE “Roza Koman”i B.I. ka ushtruar ankesë në OSHP, kundër vendimit të cituar si më sipër të AK, e cila është evidentuar me numër të protokollit 0717/2024.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 23.08.2024, ekspertja shqyrtuese ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar.

Të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës për LOT - 1 dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Konstatohet paraprakisht se, raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Në këtë rast evidentohet se të dyja palët (AK dhe OE) janë në dijeni lidhur me shkresat komplete të kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores për Punën e OSHP dhe se të dyja palët kanë deklaruar formalisht AK me 27.08.2024 si dhe OE me datën 01.09.2024 se pajtohen me rekomandimin e ekspertës shqyrtuese.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli konsideron se procedura e shqyrtimit përfundon në këtë fazë, në kuptim të pajtimit (marrëveshjes) së arritur të palëve dhe rrjedhimisht e njëjta ka humbur pretendimin, respektivisht objektin ankimor sikurse kërkohet shprehimisht me dispozitën e nenit 111, të LPP. Me rastin e shqyrtimit të shkresave të kësaj lënde, natyrës dhe qëllimit të sajë, Paneli shqyrtues konsideron se palët mund ti zgjidhin raportet eventualisht kontestuese mes vete në ato raste kur ato në saje të legjislacionit, disponojnë lirisht me të drejtat e tyre. Andaj, paneli shqyrtues nuk është lëshuar fare në vlerësim të pretendimeve ankimore por vetëm nxjerrë vendim për përfundimin e procedurës.

Pajtimi i arritur mes palëve nuk bije nesh me parimet bazë dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe nuk e atakon pavarësinë institucionale të AK saj, për të zgjidhur çështjen kontestuese, meqë e lejon natyra e çështjes në rastin konkret, mes tjerash konform nenit 19 paragrafi 4 të Rregullores se Punës së OSHP-së Nr. 01/2020 (e amandamentuar).

Megjithatë, Paneli ju kujton palëve se në kuptim të nenit 19, paragrafi 4, të Rregullores për punën e OSHP parashihet se, *cituar*: “Në rast se autoriteti kontraktues dhe parashtruesi i ankesës pajtohen me raportin e ekspertit shqyrtues, paneli shqyrtues nxjerrë njoftim që autoriteti kontraktues në afat prej 5 ditësh ta implementoj raportin e ekspertit shqyrtues duke i njoftuar palët në procedurë. Për më tepër informohen palët, që ky vendim ka karakter procedural për palët në procedurë dhe në rrethana të tilla të gjeturat e këtij raporti nuk i janë nënshtruar vlerësimit nga Paneli Shqyrtues .

Prandaj bazuar shkurtimisht në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues ne pajtim me nenin 105, 116 dhe 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES**
- **OE - Roza Komani B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: